




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-10091/23 datë: 24.04.2023



Npi – 01/182 datë: 25.04.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 25.04.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 25.04.2023 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Xhavit Fejza nga UNMIK-u.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 29.03.2023,
2. Diskutim për formimin e listës së familjeve nevojtare për renovim ose ndërtim të shtëpive,
3. Shqyrtimi Draft-Strategjis dhe planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025,
4. Shqyrtimi i Planit Komunal për Ri-integrim e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Shtimes,
5. Raport i punës së ZKKK-së për muajin prill 2023,
6. Propozim për rregullimin e varrezave të vjetra të komunitetve në fshatin Rashincë,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 29.03.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Kërkojë përmirësimin të numri të nxënësve të shkollës profesionale nga 26 të bëhet 27. Dhe e dyta e kame kamë cekur se nxënësit nuk i kanë tërhequr dokumentat nga shkolla, për këtë arsye ligjërisht nuk konsiderohen si nxënës që e kanë braktisur shkollën. Te shkolla “Naim Frashëri” duhet të theksohet se janë dy nxënës të Komitetit.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 29.03.2023.**

Pika 2

Diskutim për formimin e listës së familjeve nevojtare për renovim ose ndërtim të shtëpive

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Para se të ja japi fjalën znj.Rrezarta Ramadanit, tha MAPL-ja e ka publikuar thirrjen për aplikim për ndërtim dhe renovim të shtëpive. Shuma e planifikuar është gjithsej 3 milion euro, 2 milion për ndërtim dhe 1 milion për renovim. Propozoj që ne si Komunitet me u takuar me zyrtarët e MAPL-në për këtë çështje dhe me biseduar.

znj.Rrezartë Ramadani; Me datën 25.03.2023 kemi vizituar 40 familje dhe kemi ardhur në përfundim që 7 familje kanë nevojë për ndërtim e ata janë: Sinan Qerimi, Shashivar Tahiri, Sherif Jashari, Besnik Mehmeti, Dashnim Xhema, Avni Ilazi, dhe Mehdi Krasniqi.

z.Besnik Seferi; Kemi mbajtur diskutimin me banorë më 25.03.2023 është e dhimbshme se në far kushte jetojnë gjithë këto familje. Një pjesë ka edhe nevojë për renovim. E falenderojmë Rrezartën për shënimet që i ka marrë. Është para së gjithash obligim i yni por edhe gjest human.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Në listë i kemi 7 raste. Ne mundemi me i rekomandu OJQ-së “Jetimat e Ballkanit” që së paku 5 familje të jenë nga Komiteti Ashkali. Edhe e dyta të dakordohemi për një takim pune me këshilltarin e Ministrisë.

znj.Rrezartë Ramadani; Ne u dakorduar që të shkojmë vetëm për ndërtime.

z.Arton Demiri; Te komuniteti Rom i kanë kushtet e banimit, uroj që te Komiteti Ashkali të rezlizohet ndertimi i shtëpive.

z.Muhamet Mehmeti; Unë mendoj se është më mirë me i informuar familjet sepse nuk varet krejt nga ne se kur realizohen kërkesat e tyre.

*** Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi që t’i Rekomandoi, Kryetarit të Komunës, që në marrëveshjen e arritur me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e disa shtëpive për banim në komunën tonë të futen edhe 5 shtëpi për nevojtarët nga komuniteti ashkali.**

Pika 3

Shqyrtimi Draft – Strategjis dhe planit te veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023 – 2025

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Reshat Gashit.

z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore; Përshëndetje, më vjen keq që nuk e keni marrë materialin, ka qenë në diskutim publik por nuk ka qenë asnjë qytetarë në diskutim publik, është dokument mjaft voluminoz.

z.Besnik Seferi; Ne kemi diksutuar në Kuvend por nuk e kam lexuar, më pastaj diksutimet u bënë mes Besnik-Reshat.

***Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi që t’i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi, Draft – Strategjinë dhe planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023 – 2025.**

Pika 4

Shqyrtimi i Planit Komunal për Ri-integrim e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Shtimes

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë jo vetëm që jam “Pro” por kërkoj që të bëhet sa më shpejt.

***Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi që t’i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi, Planin Komunal për Ri-integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Shtimes.**

Pika 5

Raport i punës së ZKKK-së për muajin prill 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Shefin e ZKKK-së nuk e kemi në mbledhje prezent por po e hapi diskutimin.

znj.Rrezartë Ramadani; Propozoj që Shefi i ZKKK-së me na raportuar çdo 3 muaj, ashtu si ZKF-ja.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; E përkrahu propozimin e Rrezartës.

***Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi që Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim të raportojë në mbledhjet e Komitetit për Komunitete vetëm një herë në tre muaj, e jo për ç'do muaj siç ishte praktikë e deritanishme.**

Pika 6

Propozim për rregullimin e varrezave të vjetra të komunitetve në fshatin Rashincë

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Në Rashincë kemi kuptuar që ka varreza të Komitetit Pakicë. Ku janë përafërsisht 15 varreza aty edhe pse herë pas here i ka vershuar lumi. Ne po e shohim të arsyeshme që ato varreza të rregullohen.

z.Besnik Seferi; Është e mirë dhe e drejtë por është mirë me i rekomandu Kryetarit apo Drejtorisë për një kompani që është kontraktuar, por duhet me biseduar edhe me BIK-un, nuk e di sa po bëhet mirë sepse është çështje e ndieshme.

***Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi që për këtë pikë të grumbullojë informata shtesë deri në një mbledhje tjetër për ta nxjerrë një Rekomandim.**


Pika 7

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:17h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

